



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PEJË**  
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

**P nr. 491/17**

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P. , gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Gjyljeta Çorkadiu , në lëndën penale kundër të pandehurit L. B. , sipas aktakuzës së PPTH në Pejë PP/II nr.343/17 të dt.28.4.2017 për vepër penale : rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par 8 të KPRK-së, pas mbajtjes se seancës publike për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, të mbajtur në praninë e të pandehurit L. B, mbrojtësi të tij av. F. A. nga Peja sipas autorizimit, dhe të prokurorit të shtetit Sanije Gashi Seferi , me dt.31.5.2017 ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë :

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri L. B i lindur me dt.16.8.1998 në fsh. K. K. e P, i biri i S dhe nënës M e gjinisë M, ka të, shqiptar, shtetas i Republikës së Shqipërisë gjendet në liri .**

**ËSHTË FAJTOR**

Për shkak se:

Me dt. 29.1.2017 rreth orës 15:10 , në magjistralen P. B , pikërisht në fsh. Zllapek Komuna e Pejës , shkel ligjin mbi komunikacionin rrugor nga neni 42 pika 1 si dhe nenin 54 pika 5 dhe i shkakton lëndime të lehta trupore tjetrit dhe atë dëmtuarve E. B. , K. B , L. B , në atë mënyrë që , gjersa i pandehuri L. ishte me veturën e tij VW Golf 1K , me ngjyrë të bardhë , me targa ----- , duke qarkulluar në rrugën Pejë-Baran , me të arritur në fsh. Zllapek Komuna e Pejës , hynë në tejkalim dhe e godet me pjesë ballore automjetin Opel Corsa , ngjyrë e kaltër me targa ----- , i cili ishte duke qarkulluar nga kahja e kundërt , dhe pas kësaj goditje e përplasë në automjetin BMW, 530L ngjyrë e kaltër , me targa ----- , i cili duke qarkulluar në drejtim Pejë –Baran ku përpos dëmeve materiale lëndime të lehta trupore pësojnë të dëmtuarit e lartcekur.

-me çka ka kryer vepër penale: rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par 8 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 41,42,43,45,46, 47 dhe nenin 378 par 8 të KPRK-së, të pandehurin,

**E G J Y K O N**

Me dënim burgu në kohëzgjatje prej 3 muajsh , të cilin dënim i pandehuri do ta vuaj pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë .

Dënimin prej 3 muaj me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej **800 € (tetëqind ) euro**, të cilën i pandehuri është i obliguar ta paguaj menjëherë, në rast të mospagimit

gjopa në fjalë i zëvendësohet me dënim me burg në kohëzgjatje prej 40 ( dyzet ) ditësh, duke llogaritur 20 € (njëzet) për 1 ( një) ditë burgu .

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 80 euro kurse në emër të paushallit gjyqësorë shumën prej 20 euro – dhe të gjitha këto 15 ditë pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Të dëmtuarit për realizimin eventual të kërkesë pasurore juridike udhëzohet në kontestin e rregullt civil.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë me dt. 28.4.2017 kundër të pandehurit L.B. ka ngritë aktakuzë PP/II nr.343/17, për vepre penale : rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par 8 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë të pandehurin ta shpallë fajtorë , ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Bashkë me aktakuzën i ka dërguar gjykatës edhe njoftimin për marrëveshjen e lidhur për pranimin e fajësisë, në ç mënyrë është njoftuar gjykata për detalet dhe është lutur që të mbahet shqyrtimi gjyqësorë sa më shpejtë që është e mundur .

Në shqyrtimin gjyqësorë në të cilin kanë prezantuar i pandehuri L. B , mbrojtësi i tij av. F. A. dhe prokurori i shtetit Lumturije Hoxha është bërë e ditur përkatësisht është konfirmuar se : i pandehuri , mbrojtësi i tij dhe prokurori i shtetit me dt. 20.4.2017 kanë lidhë marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe të njëjtën marrëveshje sërish e kanë konfirmuar edhe në shqyrtimin gjyqësor, dhe këtë marrëveshje gjyqtari e ka pranuar – i bindur thellë se marrëveshja e tillë është bërë konform dispozitave të Kodit të procedurës Penale dhe të Kodit Penal të Republikës së Kosovës .

Pasi që u aprovua përkatësisht u pranua marrëveshja mbi pranimin e fajësisë gjyqtari e konfirmoj edhe vendimin mbi masën ndëshkuese ashtu siç është precizuar edhe në marrëveshjen për pranimin e fajësisë .

Ndërkohe që është refuzuar propozimi për shqiptimin e dënimit plotësues - ndalimi i drejtimit të automjetit për 1 vit si i tepërt

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 450 të KPPRK-së

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit në kontestin e rregullt civil është marrë konform nenit 463 të KPPRK-së .

Nga sa u tha më lartë konform nenit 365 të KPPRK-së u vendos si më lartë.

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë.31.5.2017

Sekretarja juridike  
Gjyljeta Çorkadiu

Gjyqtari  
Sejdi Blakaj

### KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi lejohet  
Ankesa në afat prej 15 ditësh nga  
Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë  
E përmes kësaj Gjykate .